



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e pestë e rregullt të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **29.06.2022**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 15. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 16. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 18. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 19. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 20. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 21. <u>Qerim Rexhaj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 22. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 9. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 23. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 10. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 24. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 11. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 25. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 26. <u>Melis Smakic, GIBI</u> |
| 13. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | |
| 14. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, nënkryetari i komunës, z. Ali Nimanaj, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-të e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Hapi punimet për mbledhjen e katërt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Procesverballi

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes (26) anëtarë të Kuvendit janë të pranishëm.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R E N D D I T E

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-së) për vitin 2022,
4. Shqyrtimi dhe Miratimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për Ndryshim – Plotësimin e Vendimit 01Nr.35/2022, i datës 31.03.2022 për themelimin e KKSB, me një anëtar të ri,
5. Formimi i komisionit vlerësuese për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës,
6. Formimin e komisionit për ankesa ndaj dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës,
7. Njoftimi me raportin vjetor të punës së prokurimit për vitin 2021,
8. Njoftimi me Planin e Punës së zyrës së Prokurimit për vitin 2022,
9. Shqyrtimi dhe Miratimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2025,
10. Shqyrtimi dhe Miratimi i listës për projekte të reja kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2022,
11. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu prezent janë 26 anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka nga anëtarët e kuvendit apo nga ekzekutivi.

Kryetari i Komunës – përshëndet te gjithë të pranishmit, kam dy pika që të shtohen në rendin e ditës:

1. Zgjedhja e zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për komunitete dhe
2. Bashkëpunim nderkomunal Istog - Pejë

Është projekt i përbashkët i cili ka kaluar në Ministrinë e Administrimit të pushtetit Lokal Në Pejë do të realizohet në zonën lugu i Drinit, pres nga Kuvendi autorizimin që është procedurale që të vazhdohet me marrëveshjen

Zëvendës kryesuesi për komunitete, sipas nenit 54 të Ligjit për Vet Qeverisje Lokale (sqaron procedurat për zgjedhjen e zëvendës kryesuesit për komunitete)

Ne e kemi një asambleist në Kuvend dhe ai është z. Melis Smakic , të cilin e propozoj për zëvendës kryesues dhe pres ju prej secilit që ta votoni sepse është e drejt e garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit – falënderon kryetarin për propozimet, a ka edhe dikush diçka

Niman Beqiraj – përshëndet të gjithë të pranishmit, ne jemi dakorduar që pika e dhjetë Shqyrtimi dhe Miratimi i listës për projekte të reja kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2022, që kjo listë të vjen e kompletuar dhe ti ketë vlerën e financimit nga komuniteti se sa ata kanë participuar në këto projekte, nuk na ka ardhur e kompletuar. Kemi disa dyshime se kjo është e qëllimshme dhe kisha kërkuar që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Florin Dreshaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, dua të informohem me shumë për projektin bashkëpunim nderkomunal me Pejën se si të votoj për ose kundër.

Për zëvendës kryesuesin me duket që duhet të ketë 10% të komiteteve në komunë.

Hajrush Shoshi – përshëndet të gjithë të pranishmit, është dashur që ta kemi një propozim – vendim të zëvendës kryesuesit se a kemi të drejtë edhe pse nuk e kemi përqindjen e mjaftueshme të komiteteve në komunën tonë. Jam për që të aprovohet ky propozim vetëm se të kemi me shumë sqarime.

Kryetari i Komunës – çështjen e projektit nderkomunal jua prezanton drejtori i zhvillimit ekonomik nuk ka asgjë msheft këtu.

Zëvendës kryesuesin për komunitete ne do ti jepim të drejtë është organi me i lartë që e bën shqyrtimin e ligjshmërisë së këtyre vendimeve. Pres nga ju që ta përkrahni këtë propozim.

Niman Beqiraj – ne jemi me i përkrah komitetet por nuk është vendi i rezervuar nëse nuk është 10%, nuk po e bëni për të drejtën e komitetit por për votën e komitetit pro koalicionit.

Kryetari i Komunës – z. Beqiraj emërto si të duash, tregova si është idea.

Qerim Rexhaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, materialet që po na vinë për mbledhjet e Kuvendit po e potencoj se në aspektin gjuhësor dhe drejtshkrimor janë në nivel jo të mirë. Nuk e di a ka lektor në këtë institucion a jo.

Jemi duke e diskriminuar gjuhen shqipe duke e ditur që faktikisht është nene e të gjitha gjuhëve të Evropës.

Kryesuesi i Kuvendit - nëse nuk ka edhe dikush diçka e hedh në votim këto dy pika që të hynë në rend dite

Miratohet me 14 vota për 5 kundër dhe 6 abstenime.

Hedhe në miratim komplet rendin e ditës rendin e ditës Kush është për?

Miratohet me 23 vota për dhe 2 kundër.

(në procesin e votimit mungojn Era Visoqi dhe Ardita Idrizaj)

Konstatojmë që me 25 anëtar janë prezent

Fjolla Ukaj, largohet nga mbledhja.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- në mbledhjen e sotme mungon znj. Era Visoqi pa ndonjë njoftim për mungesën e saj.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit -Për shkak se sekretaria nuk ka staf është e pa kompletuar dhe me shume mund dhe veshtersi po mundohet që ti kryej punët që janë aq të vrullshme, dhe nuk mund ti kontrolloj të gjithë materialet që vin, lektor nuk ka komuna dhe po dalin gabime drejtshkimore(gramatikore).

Procesverbalin e keni pa a ka dikush ndonjë vërejtje.

Hedh në miratim

Miratohet me miratohet unanim

Konstatohet që me 22 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar i datës 29.04.2022.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken tjetër Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-së) për vitin 2022. Fjalën ja kalon koordinatorit të KKSB-së z. Skender Hasangjekaj

Skender Hasangjekaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Planit të punës së KKSB-së për vitin 2022.

Ajshe Metaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, këtu u përmenden disa teme. Puna në sektorin privat rreth kontratave dhe orarit të punës qytetaret e punësuar në sektorin privat kanë qenë të diskriminuar në këtë drejtim. A ekziston ndonjë ligj apo inspektoriat i punës, që i përcaktojnë orarin dhe rregullat e punës në sektorin privat.

Monitorimi në të gjitha shkollat që nuk ka funksionuar me parë a është një risi me na treguar rreth rolit të këtyre shkollave çka ka ndikuar.

Emergjencat dhe ambienti nga ministria me na treguar rreth prerjes së pyjeve dhe sa behet ripërtëritja e masës drunore. Pyjet janë të rëndësishme për ambientin, a ka statistika rreth prerjes së tyre.

Të demet në bujqësi a hynë edhe breshëri sepse bujqit po dëmtohen sa mundet me i mbuluar komuna ato dëme që i ka shkaktuar breshëri.

Rreth delikucencës, sigurisë së nxënësve në shkollë, sa mbrohen nxënësit në shkollë, marrë parasysh përdorimin e drogave, çfarë masave do të ndërmerren në mënyrë që fëmijët të shpejtojnë nga ky helmim. Faleminderit kaq kisha.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Ajshe!

Skender Hasanxhekaj- edhe në përbërjet e kaluara si këshill unë kam qenë koordinatör. Kam pas shumë kërkesa nga të punësuarit sidomos të sektorit privat. Në vitin 2020 ka qenë për herë të parë kjo temë në plan të punës. Pandemia e ka bërë të veten. Unë kam qenë në dijeni që drejtoria për Zhvillim atë kohë e ka pa filluar hartimin e një Rregulloreje për rregullimin e orarit të punës meqë Ligji i Punës i përcakton shumë qartë punësimin kontratat dhe të gjitha, dhe është iniciuar kjo temë që të hartohet një

Rregullore sepse ka shumë komuna në Kosovë që e kanë rregulluar orarin dhe e kanë caktuar të dielën ditë pushimi, duke i përcaktuar sektorin e barnatoreve dhe të furrave, që punojnë me radhë në orare, përndryshe për të gjitha sektorët tjerë kanë bërë pushim ditën e diel. Në vitin 2019 në raportim në KKSBB nga inspektoriat i punës nga Peja kanë paraqitur raport të cilët janë pesë zyrtarë e mbulojnë komplet regjionin e Dukagjinit duke përfshirë edhe Gjakovën që tash është regjion në vete. Sipas atij raporti ata munden ti mbulojnë vetëm qendrat e mëdha ndërsa qendrat e vogla u mbetën komunave mirëpo aty pastaj është problem ligjor sepse komuna nuk ka inspektor të punës që mundet ti kërkoj kontratat. Kjo temë do të trajtohet, dhe do të paraqitet raporti. Është e drejtë e juaja ta nxirrni një Rregullore dhe të definohet që një ditë e javës të jetë ditë pushimi. Sa i përket monitorimit, funksionimit të këshillave të shkollave, është si temë që është paraqitur nga Arsimit pasi që raportohet nga ata në këshill për temë të përgjithshme të arsimit dhe nga përvoja ime, gjithmonë debatohet një trekëndësh prind-nxënës-mësimdhënës, dhe shumicën e radhëve problemi drejtohet te prindi. Kështu që si këshill kemi vendosur që mbledhjen e parë që e kemi mbajtur ta formojmë një komision i cili do të bëjë një hulumtim në shkolla vetëm bazuar në ligjin për arsimin para universitar ku precizohet mënyra e formimit të këshillit të shkollës, të nxënësve dhe të prindërve. Në atë komision jam unë kryesues, drejtori i drejtorisë së arsimit, një zyrtar nga policia, dhe zyrtarja që i përfaqëson ekipet vepruese për sigurinë në bashkësi. Monitorimin e kemi bërë në shkolla dhe raporti do të ju vij duke u bazuar në planin e punës. Sa i përket temës prerja ilegale e pyjeve, në të kaluarën zyra e pylltarisë në kuadër të drejtorisë së Bujqësisë i ka statistikën sa prehen, komuna e ka një marrëveshje me shërbimin sprovues të Kosovës, të gjithë ata që dënohen për prerje ilegale të pyjeve me punë në dobi të komunitetit dënohet me të holla nëse personi nuk ka mundësi ta bëjë pagesën me të holla kërkon prej gjykatës ai dënim të shndërrohet në punë në dobi të përgjithshme të komunitetit, dhe me vendim të gjykatës caktohet puna. Shërbimi sprovues e sjellë në komunë vendimin, komuna në bashkëpunim me shkolla me spitalet, me ambientin me hidrodrinin e përcakton një punë ku personi i tillë i përfundon ato orë pune. Te konfiskimi i druve një pjesë e tyre janë shpërndarë për raste sociale. Por tash është sjellë vendimi që këto të shiten me tender, dhe ato të holla përdoren kryesisht për pyllëzim. Te siguria në shkolla dhe konsumimi i drogave, në vitin 2022 kemi thirr mbledhje të KKSBB-së, nga organizata qeveritare dhe niveli qendror i policisë që e ka një njësi antidrogë dhe organizata jo qeveritare në nivel të Kosovës, të cilat e kanë të specifikuar temën e përdorimit të narkotikëve dhe fatkeqësisht fillimi i përdorueseve të drogave në Kosovë tash ka rënë në moshën 14 vjeçare, për fat të mirë në vitin 2019 në Istog kemi qenë shumë më mirë se sa komunat tjera në Kosovë, por është një numër i përdorueseve, po flas për statistikën që na kanë dhënë në vitin 2019, kurse pandemia ka krijuar situatën që në vitin 2020 dhe 2021 kemi pasur vetëm një mbledhje si KKSBB, dhe nuk kemi pasur mundësi t'i trajtojmë këto tema. Sa i përket fatkeqësive natyrore, ligji për fatkeqësi natyrore përcakton nivelin e fatkeqësive për të cilat realisht me Ligjin për Vetëqeverisje lokale e gjithë pesha i bie komunës, mirëpo kur kalon në një nivel të dëmit, komuna me buxhetin e vet është e pamundur të ju përgjigjet popullatës dhe i drejtohet ministrisë që ministria ta mbështetë.

Kryesuesi i Kuvendit- ekzaminim më të fortë se di kush mundet të jap në Kosovë. Ajshe Metaj e ka fjalën pastaj Qerim Rexhaj.

Ajshe Metaj-u tha që gjatë pandemisë nuk kanë pasur mundësi të mbajnë mbledhje të KKSBB-së, dhe unë i takoj kësaj strukturës së arsimit dhe marrë parasysh seriozitetin e

çështjes që u trajtua, pandemia tashmë ka kaluar, çka mundemi të bëjmë të ndalojmë këto raste të mos përkeqësohet situata më tutje rreth përdorimit të drogave. Kaq kisha unë. Se ju e keni shtjelluar shumë mirë pa asnjë lloj keqkuptimi kryesues, po mua më është dukur se ka kaluar ajo se çka mundemi të bëjmë më shumë, duke marrë parasysh se situata nuk është aq e mirë. Faleminderit!

Skender Hasangjekaj- nuk desha ta prek shumë këtë temë, qëllimi është që kjo temë të trajtohet në muajin tetor, paraprakisht si KKSB në bashkëpunim me kryetarin, komandantin e policisë, dhe ato organizata që merren me këto gjëra. Ideja ka dalë në takimin në vitin 2019 që të mbahen ligjërata në të gjitha shkollat, ne e kemi mbajtur një ligjëratë me ekipin veprues për siguri në bashkësi në atë kohë, por nga të gjitha shkollat kemi marrë nga pesë nxënës, sepse kushtet nuk na kanë lejuar pikërisht në këtë sallë, qëllimi ka qenë që të jetë një plan që të përfshihen edhe mjetet buxhetore. Kur të hartohet ai plan me të gjitha takimet dhe mjetet buxhetore sepse nuk ka qenë e paraparë në planet buxhetor për vitin 2022, dhe mendoj që duhet të ju sillët juve këtu nëse ka hapësirë për mjete buxhetore shtesë.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit z. Koordinator. Fjalën e ka Qerim Rexhaj

Qerim Rexhaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! E kam lexuar këtë plan dhe e kam parë që janë prekur shumë pika të rëndësishme. Megjithatë këtij plani është dashur t'i shtohen edhe disa elemente të tjera për të qenë një plan më i plotësuar dhe më funksional për sigurinë e banorëve të trevës sonë. Ndër përparësitë që do të siguronin një ambient më të sigurt për jetën e banorëve do të përmendja, ndërtimin e trotuareve për nxënësit e shkollave fillore buzë rrugëve magjistrale si p.sh afër shkollës Llukac i Thatë, Drejtë Zallq e ndonjë shkolle si këto ku nuk ka trotuar. Të ndërtohet një mburojë përgjatë lumit Qaush nga ana e rrugës në drejtim të tregut ku rrezikohen fëmijë dhe pleq për të rënë në kanal. Të ndërtohet një digë në Bollovan për të parandaluar vërshimet e herë pas here që po përfshijnë edhe qendrën e qytetit me kohëzgjatje bukur të madhe. Të bëhet pastrimi i materialit vërshues i digave aty ku janë të ndërtuara, si p.sh në Cerrcë Lubozhdë dhe në vende të tjera për të parandaluar vërshimet.

Kryesuesi i Kuvendit- Qerim, pak më në temë me qenë.

Hajrush Shoshi- nuk është pikë e rendit të ditës kjo.

Qerim Rexhaj- janë gjetur një arsenal i tërë i armëve, për këtë arsye duhet pasur kujdes më mënyrë që te mos ndodhë më e keqja duke poseduar armë të tilla. U përmend edhe në material dukuria e ekstremizmit që është e një rëndësie të madhe në këtë kohë të brishtë, kur Kosova po kërcënohet prej rreziqeve të ndryshme, Ballkani po edhe krejt Evropa, në këtë rast duhet të jemi të vëmendshëm që struktura kompetente të jenë gjithmonë në shërbim të sigurisë tonë dhe më gjerë. Ishte këtu edhe e çështja e vërshimeve, erërave, breshëritë, unë nuk e di, por në të kaluarën ka pasur qendra raketore kundër breshërit, nuk e di a ka mundësi që një gjë e tillë të insistohet që përsëri të vendosen këto qendra, në mënyrë që sado kudo bujqit të mbrohen nga të reshurat atmosferike, ka edhe tema të tjera por po besoj që mjafton.

Kryesuesi i Kuvendit, faleminderit Qerim! Florin Dreshaj e ka fjalën.

Florin Dreshaj- unë desha të shpreh pakënaqësinë time që i ndërhyt profesorit Qerim gjatë fjalës. z. Hajrush Shoshi nuk ka të drejtë ta ndez mikrofonin pa ja dhënë fjalën askush. Asgjë nuk pati jashtë rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- kërkojmë falje, të kërkoj falje në emër të Hajrushit.

Hajrush Shoshi- unë kam respekt ndaj Qerimit, është profesor i nderuar, por është mirë që si anëtarë të Kuvendit mos me dalë jashtë temave të rendit të ditës, ku ne sot e kemi edhe KAB-in mund të bisedojmë për të gjitha projektet, kemi mbetur 1 orë e 10 minuta me dy pika të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- KKSB-ja është këshill që jep rekomandime, udhëzon, i propozon, qeverisë komunale.

Skender Hasangjekaj- është e vërtetë i nderuar se të gjitha çështjet që i ngrite në një lloj mënyre atakojnë qytetarin dhe ndikojnë në çështje të sigurisë, mirëpo siç e tha sqarimin kryesuesi, KKSB-ja është organ konsultativ, këshillues për kryetarin dhe asamblenë. Pikat që kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin e trotuareve janë të prekura për aq sa ndikojnë ekskluzivisht në sigurinë e personave me aftësi të kufizuara. Në planet zhvillimore që i bëjnë drejtoritë, nuk mundet KKSB-ja me ndërhyrë, mund vetëm të sugjerojë. Sa i përket çështjes së breshëritë jam në dijeni që nga viti 2020 duke e marrë edhe sektorin që atëherë e kam udhëheq KFOR-i nuk ka lejuar që komunat t'i përdorim. Jam në dijeni që ministria e Bujqësisë ka filluar me një koordinim të punëve që të planifikoj ndërtimin e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit shumë, për një ekzaminim të mirë një plan të punës që nuk ka më mirë.

Pyes anëtarët e Kuvendit kush është që ky plan të miratohet?

Konstatohet që me 20 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-së) për vitin 2022.

Shqyrtimi i pikës së 4.

Kryesuesi i Kuvendit- kryetar, fjala është për ju.

Kryetari i komunës- faleminderit kryesues! Po i ritheksoj fjalët e takimit që e kemi pasur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, gjatë takimit në qendrën korrektuese në Dubravë ka qenë kërkesë e strukturës udhëheqëse, konkretisht e u.d të drejtoreshës që ata me e pasur një përfaqësues në KKSB. Është organ i ndjeshmërisë së lartë, operon më komunën tonë, dhe unë mendoj që është e rrugës që një anëtar me propozim të tyre të vijë dhe të bëhet pjesë e KKSB-së në mënyrë që me i pasur informacionet prej asaj qendre. Kërkoj nga ju që me e përkrah këtë propozim vendim. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- e hap diskutimin rreth kësaj pike? Pasi nuk ka, e hedh në votim?

Kush është për miratimin e propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për Ndryshim – Plotësimin e Vendimit 01Nr.35/2022, i datës 31.03.2022 për themelimin e KKSB, me një anëtar të ri nga qendra korrektuese në Dubravë?

Konstatohet që me 23 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet propozim vendimi i Kryetarit të Komunës për Ndryshim – Plotësimin e Vendimit 01Nr.35/2022, i datës 31.03.2022 për themelimin e KKSB, me një anëtar të ri nga qendra korrektuese në Dubravë.

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit- këtu nëse nuk ka dikush diçka të diskutoj, çelësi i këtij komisioni në bazë të ligjit përbëhet prej pesë anëtarëve, dy janë nga Kuvendi dy janë propozim nga kryetari dhe një nga shoqëria civile. Ky komision me ligj formohet për çdo vendim, p.sh janë dhjetë kërkesa përnjëherë, i shqyrtojnë ato dhe i skadon afati komisionit. Kurse mbledhjen e radhës caktohet komisioni tjetër në këtë përbërje. Pra të jemi të qartë.

Ajshe Metaj- a është decidivisht që ky komision të jetë prej pesë anëtarëve se unë në ligj e kam shikuar mund t'i ketë shtatë anëtarë?

Kryesuesi i Kuvendit- ligji i vjetër e parasheh me shtatë, ligji i ri me pesë. A ka propozime? Haki Podrimaj e ka fjalën.

Haki Podrimaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Nga LDK-ja propozojmë Faruk Kabashin.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit! Nga AAK-ja?

Agron Dreshaj- faleminderit! Nga AAK-ja propozojmë Fjolla Ukaj.

Kryesuesi i Kuvendit- kryetari i ka propozimet e ekzekutivit.

Kryetari i komunës- nga ekzekutivi, propozojmë Agon Dreshaj drejtori i drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, dhe Genc Ademaj drejtor i drejtorisë për Zhvillim Ekonomik. Si dhe nga shoqëria civile po i pres propozimet nga dy organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që mos me i imponuar emrat unë si kryetar i komunës. Por si komunikime jo zyrtare që i kemi për këtë komision vjen Rexhë Mulaj prej organizatës “Vizon 02” mirëpo po e pres propozimin zyrtar nga organizata.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar! E hedh në votim kush është për që të jetë ky komision vlerësues prej pesë anëtarëve dhe në këtë përbërje prej këtyre emrave?

Konstatohet që me 23 vota për aq sa janë të pranishëm votohet që komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të ketë këtë përbërje.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit- edhe ky komision përbëhet nga pesë anëtarë po nga e njëjta përbërje si te komisioni vlerësues, por për dallim nga komisioni i mëparshëm ka mandat dy vjeçar. Hajrush Shoshi e ka fjalën.

Hajrush Shoshi- nga LDK-ja propozojmë Haki Podrimaj.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- nga AAK-ja propozojmë Negdet Ramaj.

Kryesuesi i Kuvendit- kryetar fjala është për ju.

Kryetari i komunës- nga ekzekutivi propozoj, Kushtrim Buleshkaj drejtor i drejtorisë së Inspektionit dhe Gazmend Sadrijaj zyrtar ligjor në sektorin e Kadastrës, po ashtu e kemi njëjtë si në komisionin e mëparshëm emrin e gatshëm nga shoqëria civile në komunikim jo zyrtar nga organizata "Liria I" Fabian Ferizaj, mirëpo po e presim propozimin zyrtar. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- E hedh në votim kush është për që të jetë ky komision për ankesa prej pesë anëtarëve dhe në këtë përbërje prej këtyre emrave?

Konstatohet që nga 24 anëtarë të Kuvendit sa janë të pranishëm 23 vota për 0 kundër dhe 1 abstenim votohet që komisioni për ankesa ndaj dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të ketë këtë përbërje.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit- kryetar fjala është për ju.

Kryetari i komunës- e ftoj shefin e prokurimit z. Gëzim Ademaj.

Gëzim Ademaj- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton raportin vjetor të punës së prokurimit për vitin 2021.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Gëzim! Hap diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- desha mu ndal pak në dy pika, rreth kësaj kontratës që ju e keni nënshkruar dixhitalizimi i klasave në shkolla dhe rreth blerjes së teknologjisë informative.

Gëzim Ademaj- janë dy aktivitete të prokurimit që kanë qenë të planifikuara nga drejtorja e Arsimit. Është iniciuar kërkesa bashkë me përshkrimin teknik, ne si prokurim

e kemi bërë publikim e njoftimit për kontratë, se dy aktivitete të prokurimit nuk janë realizuar, sepse palët e interesit që kanë shprehur konkurrencë kanë bërë ankesë, bordi i OSHP-së i emëruar përveç ekspert prej OSHP-së që kanë dhënë mendim, kjo është dukuri në të gjitha organizatat buxhetore, ne nuk kemi mundur me vazhduar me hapa tjerë pa vendim të OSHP-së. Si total janë tri aktivitete të prokurimit që lëndët kanë shkuar në OSHP dhe që kanë mbetur të pazgjidhura.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Gëzim. A ka dikush që dëshiron ta marrë fjalën.

Ajshe Metaj- unë po kam dëshirë nganjëherë me i diskutuar disa gjëra, por nuk po dua para kolegëve të mi të dukem autoritare që me e marrë vetëm unë fjalën. Fillimisht është realizuar një projekt rreth renovimit të dysHEMEVE në gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog dhe projekti ka pas kushtuar 16.666 euro mirëpo është dashur edhe njëherë të intervenohet e tash po atë projekt e kam parë këtu 20.000 euro, tani a përfshihet edhe ajo pjesa që është rinovuar apo çka është në pyetje. Dhe rreth transportit të nxënësve, kjo nuk të përket ty, por kërkoj nga drejtorja e arsimit, që herën tjetër nëse është i përgatitur me më dhënë sqarim pak më shumë. Faleminderit!

Gëzim Ademaj- sqaron pyetjen që është drejtuar nga Ajshe Metaj.

Kryesuesi i Kuvendit- urdhëro Agron Gashi.

Agron Gashi- unë e kam një pyetje për zyrën e prokurimit, sidomos sa i përket këtyre kontratave emërtimi i rrugëve në fshatin e caktuar. Kemi hasur edhe më herët në probleme të tilla, ku qytetarët nuk e dinë se cilat janë, nuk specifikohen sa metra janë, cilat lagje, dhe sa është kostoja, vetëm e shohim një shabllon ndërtimi i rrugëve në këtë fshat. Kisha propozuar me i ikur kësaj retorike, dhe me i precizuar detajet për çdo projekt.

Gëzim Ademaj- janë të ndara përgjegjësitë, duke filluar prej njësisë, kërkesës të prokurimit dhe ekzekutimi i kontratës. Ju si Kuvend e apromoni buxhetin, thuhet konkret emërtimi "asfaltimi i rrugëve në Prigodë", dhe qëndrojnë prapa fjalës time që njësia e kërkesës specifikon, rruga "Bajram Gashi" por është asfaltimi i rrugës si term si emërues i përbashkët në atë fshat. Nëse ke ndonjë projekt konkret, urdhëro e ke të specifikuar.

Agron Gashi-unë thashë me i specifikuar për neve që i votojmë këtu këto projekte. Kur thua ndërtimi i rrugëve në "Cerkolez" specifikoj sepse ne jemi duke i votuar ato.

Kryesuesi i Kuvendit- Niman Beqiraj e ka fjalën.

Niman Beqiraj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Ne jemi demokraci përfaqësuese, nuk munden të gjithë qytetarët e komunës të vijnë në zyrë, çdoherë kur ka një projekt të caktuar. Për këtë është Rregullorja për të cilën ju duhet të jepni arsytimin. Unë po pajtohem me vërejtjen e kolegut Agron, për shumësinë e rrugëve me një emër, unë këtë

vërejtje e kam dhënë para dy muajve, e kisha prit që vërejtjet tona, si përfaqësues të atyre qytetarëve të merren parasysh.

Kryesuesi i Kuvendit- fjala është për kryetarin e komunës.

Kryetari i komunës- nuk është çështje e zyrës së prokurimit, është e planifikimit të buxhetit që e bëjmë ne në Kuvend në bashkëpunim me juve. Të njëjtat vërejtje mundemi me i ngrit kur vjen çështja e përpilimit të buxhetit për vitin e ardhshëm, edhe i eliminojmë si probleme. Zyra e prokurimit thjeshtë e procedon në formën që ne e dërgojmë. Gëzimi e sqaroi shumë mirë se prej njësive të kërkesës shkojnë me emra të saktë të rrugëve. Nuk e nënshkruan zyrtari kryesor financiar pa e specifikuar rrugën.

Kryesuesi i Kuvendit- fjala është për Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- zakonisht kjo është e shprehur ditëve të fundit të fushatës, shumësia e rrugëve kur ja dërgojnë politikisht rrugën në një lagje një njeri në shtëpi që është me një subjekt të caktuar politik, është mirë me u specifikuar, unë në këtë rast nuk po them që Gëzimi është fajtor, por kushdo që është me e marrë si vërejtje dhe me e marrë parasysh për radhët e tjera. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka rreth kësaj pike? Ne e ekzaminuam këtë pikë, ky është vetëm raport nuk votohet.

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit- Gëzim Ademaj fjala është për ju.

Gëzim Ademaj- prezanton Planin e Punës së zyrës së Prokurimit për vitin 2022.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Gëzim! Fjala është për Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! I kam analizuar të gjitha kontratat e planifikuara për vitin 2022, dhe kam vërejtur që nuk keni paraparë ndonjë investim kapital për turizëm malor, përveç 25.000 euro të cilat do të shfrytëzohen në ndërtimin e "Via Ferrata" në Mokën dhe 20.000 euro për ndërtimin e lkenve artificiale, janë edhe 8.000 euro për ndërtimin e shtëpizave nga druri. Ne si banorë të Istogut të cilët mburremi me bukuritë natyrore të bjeshkëve tona, jemi të interesuar ta dimë a do të bëhet ndërtimi i një hoteli apo bujtinave për akomodim të turistëve ndërkombëtar dhe vendor në bjeshkët e Moknës, pasi që ju si kandidat për kryetar gjatë fushatës keni premtuar një të tillë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- urdhëro kryetari i komunës e ka fjalën.

Kryetari i komunës- Negjdet faleminderit për pyetjen! Po i kam premtuar, por tani po flasim për një buxhet që ka qenë i miratuar nga asambleja e kaluar. Momentin që vijmë te përpilimi i Draft- Buxhetit të vitit të ardhshëm sigurisht që kanë me qenë pjesë e buxhetit këto hotel- bujtinat që kanë me qenë në shfrytëzim të banorëve në mënyrë që me pas mundësi me i prit turistët ndërkombëtar, por edhe lokal. Plani për investimin

në turizmin malor është më i gjerë se sa bujtinat dhe "Via Ferrata", por kur të vjen koha e përpilimit të buxhetit besoj kemi me pasur mjaftueshëm kohë të diskutojmë bashkërisht me juve.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar! A ka edhe diskutues të tjerë? Mua më duhet pasi që është plan i punës ta hedh në votim. Kush është që të miratohet Plani i Punës së zyrës së Prokurimit për vitin 2022?

Konstatohet që janë 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm nga të cilët me 18 vota për, 0 kundër dhe 4 abstenim votohet Plani i Punës së zyrës së Prokurimit për vitin 2022.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit- fjala është për Genc Ademaj.

Genc Ademaj- prezanton Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapim debatin rreth kësaj pike, urdhëroni? Ajshe Metaj është lajmëruar.

Ajshe Metaj- u tha te kanalizimi në lagjen "Lipaj" janë 7.000 euro, çka është kjo, sepse është kryer kanalizimi, a është mbetje e projektit?

Genc Ademaj- te kjo pjesë drejtori e ka përgjigjen, ka ndodhë një konflikt nga pala e cila ka dashur të ngrit padi për shkak se një pjesë e kanalizimit ka kaluar nga prona private, ai nuk e ka dhënë pëlqimin, ka qenë jashtë vendit, për këtë arsye projekti do të devijohet në atë pjesën ku ka pasur pengesa, që mos me ardhur deri te bllokimi i kanalizimit.

Ajshe Metaj- faleminderit! Edhe e kam pyetjen tjetër ndërtimi i shtegut "Rranza" për ecje. Nuk po di se ku është?

Genc Ademaj- ndërtimi i shtegut "Rranza" për ecje është te drejtimi i Cerrcës. Ka me u ndërtuar në lartësi mbidetare afërsisht 650 m, do të bëhet një hapje që ka me qenë edhe për çiklizëm edhe për këmbësorë. Do të ndërtohet trase e re në atë pjesë.

Ajshe Metaj- te ndërtimi i kalesave për personat me aftësi të kufizuar në institucionet publike. Në cilat shkolla? Dhe ndërtimi i stadiumit ndihmës të futbollit me bari sintetik, po me intereson ku në cilin vend?

Genc Ademaj- klubi i sportit të futbollit "Istogu" ka kërkuar një hapësirë për ndërtimin e stadiumit ndihmës i futbollit me bari sintetik, kemi biseduar me ta për pjesën te Bollovani që ka qenë pronë nën menaxhimin e Agjencionit Pyjor të Kosovës, i kemi dërguar geodetët në teren me e bërë incizimin e hapësirës prapa gjimnazit të lumit Qaush për ndërtimin e stadiumit ndihmës të futbollit me bari sintetik. Ka gjasa me u realizuar në bashkëfinancim me klubin. Do ju njoftojmë edhe juve si Kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit- Agron Gashi e ka fjalën.

Agron Gashi- e kam analizuar këto projekte të investimeve kapitale edhe janë nevoja të të gjithë qytetarëve. E kam thënë edhe në seancën e kaluar po e them prapë, po më pengon pjesa e gjithë përfshirjes apo prioriteteve në fshatra, nuk po e gjej nëpër plane në buxhet, këto prioritete që po i kërkojnë. Disa prej tyre kanë mungesa bazike, duhet të bëhet një balancim.

Kryesuesi i Kuvendit- Genc Ademaj fjala është për ju.

Genc Ademaj- marrë parasysh mundësitë buxhetore që i kemi, është e mirë ajo me e pas një gjithë përfshirje, por nëse e bëjmë një planifikim të mirëfilltë për katër vite, ose për tri vite siç na e kërkon Qarkorja, në bazë të kësaj mundemi me i caktuar bashkë prioritetet, edhe prej mbledhjeve edhe prej dëgjimeve.

Kryesuesi i Kuvendit- Hajrush Shoshi është lajmëruar.

Hajrush Shoshi- nuk dua ta zgjati shumë, edhe te arsimi duhet të ndërhyhet, te subvencionet dhe transferet, është shumë pak 33.750 euro, nëse i shtohet kësaj se këtë vit janë shtuar edhe afër 50.000 euro për bursa, jemi obligues që edhe vitin e ardhshëm të ja u paguajmë atyre. Edhe te pjesa e mallrave dhe shërbimeve, besoj që drejtori do ta precizoj më mirë, shpenzimet e transportit janë shumë më të larta sesa 45.000 euro a sa janë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- Genc Ademaj.

Genc Ademaj- te kjo pikë bashkë me drejtorin mund ta shikojmë kur të vjen Qarkorja e dytë buxhetore, te pjesa e ngritjes së subvencioneve ne mund të kërkojmë 1 milion euro, por aprovimin e dimë që para 3 viteve kemi filluar me 260 mijë euro, kemi arritur me një ngritje graduale për shkak të arsyeshmërisë së mirë që ka ardhur e kemi ngritur në 319 mijë euro. Te paraqet drejtori me stafin e vet edhe e rregullojmë.

Kryesuesi i Kuvendit- Haki Podrimaj e ka fjalën.

Haki Podrimaj- ka kërkesa të shumta por të gjitha në fund nuk mund të realizohen. Ne do të jemi bashkë me ekzekutivin dhe do ti japim prioritet atyre çështjeve që kërkojnë prioritet. Isha ndalur te arsimi, që të rritet kapaciteti i çerdheve sa ka mundësi.

Kryesuesi i Kuvendit- kryetari i komunës e ka fjalën.

Kryetari i komunës- Haki desha të ndërlidhem te çështja e çerdheve, e kemi edhe premtim elektorale që me e arritur brenda mandatit, që të ketë vend për secilin fëmijë në çerdhe. Për momentin kemi problem të jashtëzakonshëm. Nëse nuk jam gabim, ka arritur deri në 100 numri i aplikantëve për 26 vende të lira në tërë territorin e komunës së Istogut. Ne e kemi dorëzuar një projekt me kërkesën për një çerdhe të re në Gurakoc, e dini se në çfarë gjendje është ajo. Planifikimi është që të zgjerohet edhe në Banjë për një klasë, edhe në Rakosh ka filluar kompania ta bëjë rinovimin dhe zgjerojë kapacitetin. Telashe ka edhe me çerdhen që janë bllokuar punimet në Istog, kontrata është e bërë prej

ministrisë së Arsimit, nuk kemi pasur kompetencë ekzekutive lidhur me atë projekt, mirëpo secilën rrugë që e kemi pasur për komunikim me ministrinë e kemi shfrytëzuar në mënyrë që me e obliguar operatorin me i filluar punimet ani pse po flasim për problem global të çmimeve, por është kontratë e nënshkruar dhe ata janë të obliguar që ose ta shkëputin kontratën ose me rishpallë sepse punimet janë në ngecje. Mendoj që me këtë trend deri në fund të mandatit secili fëmijë me e pasur vendin e vet në çerdhe. Në çerdhen në Vrellë veç ka filluar inventarizimi, në shtator lëshohet në funksion çerdhja e re komplet. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar! edhe dikush diçka rreth KAB-it? Urdhëro Visar Haxhijaj.

Visar Haxhijaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Nga lëmia e shëndetësisë një planifikim kisha pasur dëshirë, është nevojë e të gjithëve, nuk ka planifikim për pacientë që kanë nevojë jashtë vendit me u trajtuar. Këtë planifikim nuk po e shoh askund, komunat tjera e di që e kanë, kam pasur përvojë në këtë drejtim, besoj e dini. Kisha pasur dëshirë me e ndarë një buxhet për këta njerëz, se është e rëndë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka kryetari i komunës.

Kryetari i komunës- me sa kam informacion ministria e Shëndetësisë e ka një buxhet të ndarë që ju ndihmon rasteve që kanë nevojë për trajtim jashtë vendit, nëse nuk gaboje është rreth 5 milion euro në total. Kompetencë e ministrisë është me i ndarë maksimalisht 30 mijë euro për sëmundjet që trajtohen jashtë vendit. Çka ne si komunë e kemi si mundësi me e bërë përmes kategorisë subvencione me e përkrah sa na lejon ligji për një rast edhe normalisht përmes përkrahjes me derivate që bëhet në baza ditore janë shumë ma shumë raste Visar. Jemi duke u mundur me i përkrah sa na lejon ligji edhe sa kemi mundësi buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit- Visar Haxhijaj e ka fjalën.

Visar Haxhijaj- unë po mendoj për këta çka kanë nevojë për trajtim jashtë vendit, se këto trajtimet këtu prapë mbulohen disi. Qytetarë të Istogut që kanë nevojë janë dy tri raste brenda vitit që kanë nevojë jashtë vendit që e fitojnë atë të drejtë.

Genc Ademaj- atëherë Visar unë mendoj që ne mundemi me e krijuar një grup punues për Rregulloren për subvencione që e kemi, edhe me e shtuar një nen të veçantë aty, d.m.th për sëmundjet që kërkojnë trajtim jashtë vendit, munden me u zotuar një shumë prej 10 mijë eurove në vit ose 20 mijë varësisht prej kërkesave sa kemi edhe përmes Kuvendit mundemi vazhdimisht me e orientuar dhe me e provuar atë. Unë nuk jam për atë që çdo përkrahje te orientohet në Kuvend, puna që nëse planifikojmë Rregullore mbështetemi në të dhe mundemi me e ndarë një shumë sa dakordohemi dhe nuk është problem. Mundemi ta bëjmë është e realizueshme. Bashkë me drejtorinë e Shëndetësisë në mbledhjen e ardhshme e draftojmë Rregulloren e pasurojmë me këtë nen edhe nuk do të ketë problem.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! A ka edhe dikush që dëshiron të diskutoj rreth kësaj pike? Atëherë e hedh në votim, kush është që të miratohet Draft Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025?

Konstatohet që me 19 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet Draft Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025.

Shqyrtimi i pikës 10

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken e radhës, fjalën e ka Genc Ademaj.

Genc Ademaj, Drejtor për Zhvillim Ekonomik - bën prezantimin dhe sqarimin e listës për projekte të reja kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2022.

Hajrush Shoshi – pasi që drejtori po e merr përsipër që në mbledhjen e ardhshme me na i sjell të gjitha shënimet jam që të kalohet kjo pikë e rendit të ditës sepse qytetaret i kanë dhënë mjete kanë participuar për projektet e tyre.

Florin Dreshaj – pyete nëse këtë punë e lemë për muajin tjetër a i nxajmi afatet, sepse pa çmime mund të kemi dyshime për manipulime.

Genc Ademaj – këtu nuk ka mundësi për manipulime janë në listën e projekteve numri i kërkesës emri i përafruesve lagja dhe gjatësia e rrugës që është kërkuar. Çmimi varion varësisht nga tregu. Janë disa procedura të cilat marrin kohë deri në kontraktim.

Kryesuesi i Kuvendit – pasi që diskutime tjera nuk ka e hedh në miratim.

Kush është për:

Miratohet unanim Lista e projekteve të reja kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2022.

Konstatohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit, gjithsejtë të pranishëm në sallë janë 19 anëtarë të Kuvendit.

Shqyrtimi i pikës 11

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken e radhës,

Zgjedhja e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të komunës së Istogut, e propozuar nga Kryetari i Komunës. I propozuar për zëvendës kryesues është z. Melis Smakic anëtari me i votuar nga radhët e komiteteve në Kuvendin e Komunës së Istogut.

A ka dikush diçka?

Pasi që diskutime nuk ka hedh në votim kush është për?

Zgjidhet z. Melis Smakic Zëvendës Kryesues i Kuvendit të komunës së Istogut.

Me 16 vota për 3 kundër dhe 1 abstenim

20 anëtar prezent në sall.

Kryesuesi i kuvendit – përshëndet z. Smakic i uron për zgjedhjen Zëvendës Kryesues i Kuvendit të komunës së Istogut. Dhe ja kalon fjalën për një përshëndetje.

Melis Smakic - përshëndet të gjithë të pranishmit , falënderon për votimin dhe mbështetjen, do të punojmë bashke.

Shqyrtimi i pikës 12

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken e radhës,
Bashkëpunimi Nderkomunal Istogu me Pejën. Fjalën ja kalon z. Genc Ademaj

Genc Ademaj, Drejtor i zhvillimit Ekonomik - bën prezantimin dhe sqarimin e Bashkëpunimi Nderkomunal Istogu me Pejën.

Kryesuesi i Kuvendit - pasi që diskutime tjera nuk ka,
Hedh në votim,

Miratohet unanimit Autorizimi i kryetarit të Komunës për Bashkëpunimi Nderkomunal Istogu me Pejën.

Prezent sa sallë 19 anëtar të Kuvendit të Komunës.

Shqyrtimi i pikës 12

Kryesuesi i Kuvendit – pika e fundit për këtë mbledhje, pyetje dhe përgjigje nga ana e drejtorëve të parashtruara nga anëtarët e Kuvendit në mbledhjen e fundit të Kuvendit.

Niman Beqiraj - kërkon që kjo pikë të merrem me më seriozitet, roli i asamblistit është që ti përfaqësojmë problemet e fshatrave dhe të gjithë qytetarëve të komunës së Istogut me i sjell në asamble, dhe kjo po përfundon veç me pyetje dhe përgjigje.

Ne i kemi bere disa pyetje por rëndësia e tyre nuk po merret parasysh po përfundon me një përgjigje. Kam pasur pyetjen për sallën e sportit në fshatin Vrellë dhe drejtoresha e sportit ma ka kthyer përgjigjen pas dyjave do të vazhdojnë punimet është bere dy javë dhe nuk ka startuar ende me punë.

Kolegu Visar Haxhijaj e ka kërkuar një polic të vdekur që disa në qendër të fshatit Vrellë të shkolla fillore ndërkaq prej asaj kohe i kemi tri aksidente që fatmirësisht s kan qenë me fatalitet mirë po me lëndime të renda trupore.

Nëse punët nuk po kryhen me kohë ju lutem merrni përgjegjësit për demet e shkaktuara.

Florin Dreshaj – mbledhjen e kaluar kam pasur pyetje për drejtorin e bujqësisë që nuk ka qenë këtu dhe nuk kam marrë përgjigje.

Niman Beqiraj – është e vërtet që se ca përgjigje janë dhëne por neve nuk po na mjaftojnë përgjigjet po duam punë.

Abedin Kabashi, Drejtor i Shërbimeve Publike – përshëndet të gjithë të pranishmit, kontratë ende nuk kemi për vendosjen e pulisëve të vdekur momentin që do ta bëjmë kontratën do ti vendosim, neper vende ku ka nevojë.

Niman Beqiraj – kryetari ka të drejt me e bë një kompani multifunkionale që i përfshin të gjitha këto punë që mos me pas nevojë me prit kontratat.

Kryetari i Komunës – është e vërtet që kryetari ka të drejta po për ti shfrytëzuar ato të drejta janë disa ligje që po na marrin kohë, procedurat.

Qerim Rexhaj – kërkesa e banorëve të fshatit Lubozhdë për ndarjen e lokacionit të varrezave në “Pollaqer” , deri ku ka ardhur procedura apo çka duhet të bëjmë që të shtyhet me tutje.

Genc Ademaj – jemi në dijeni për këtë krekës kemi ndërmarr hapa konkretë kemi ndar një shumë të mjeteve buxhetore për ato varreza, ka disa problemë mes lagjeve ku ndoshta na duhet të ndahen dy lokacione për varreza në Lubozhd.

Valbona Demaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kërkesa nga disa prindër a ka mundësi që kiosqet që janë ne rrugë të vendosen brenda oborrit të shkollave?

Naim Belulaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, ka mundësi por së pari duhet ta hartojmë një Rregullore që të i rregullojmë këtë çështje.

Ardita Idrizaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, a do të ketë noter në komunën tonë?

Kryetari i Komunës – kjo është një prej çështjeve që e kam ngritur edhe në Kuvendin e Kosovës sa kamë qenë, nuk është kompetencë e kryetarëve të komunave.

Haki Podrimaj – emërtimi i rrugëve ka rrugë të reja se janë qelur, a ka paraparë diçka drejtori në këtë aspekt?

Dukagjin Hoxhaj, drejtor i urbanizmit - përshëndet të gjithë të pranishmit, për momentin nuk mund të intervenojm ne emërtimin e rrugëve sepse e kemi një memorandum që duhet ta respektojmë. Se bashku me kryetarin do ti marrim të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe do bëjmë rifreskimin e emrave të rrugëve, sipas ligjit të adresave.

Faik Alushaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kur do të përfundoj sheshi në qendër?

Kryesuesi i Kuvendit , falënderon të gjithë për durimin që patën, edhe pse në mbledhje vetëm 19 anëtar janë nuk është në rregull .

E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme. Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:30

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj



17

Procesverbali



Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova

